

## **SHTOJCA NR. 3 “ZBATIMI I FONDIT LIMIT TË PAGAVE”**

Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahet në konsideratë që:

I. Referuar ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 “Për Kompetencat për Përcaktimin e Pagave dhe të Shpërblimeve”, neni 2, në administratën publike, të drejtën përcaktimin e pagës e kanë vetëm Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.

II. Referuar ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, Neni 3, paga më e lartë në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jo buxhetore, në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës, e cila përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit. Paga minimale mujore në shkallë vendi dhe kufiri minimal mujor për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

III. Paga e funksionarëve të lartë shtetëror të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 i sipërcituar, përcaktohet në raport me pagën e Presidentit sipas lidhjes përkatëse të këtij ligji.

IV. Pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 i sipërcituar, si dhe pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar të gjithë njësisve të qeverisjes së përgjithshme, përcaktohen me Vendimin me nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim. Në këtë vendim, vlera e pagës së diplomës është e grupuar në 3 nivele dhe çdo pozicion pune ka një emërtesë të përcaktuar që i përgjigjet detyrimisht një niveli të caktuar të diplomës (pagës së grupit). Kjo nënkupton që në një funksion, i cili ka në emërtesën e tij, pagën e grupit 1, nuk mund të emërohet një nëpunës, i cili ka përfituar një diplomë të grupuar në nivelin 2. Vendimi i sipërcituar, i miratuar me ndryshime në vitin 2013, përmban disa ndryshime, ku ndër të tjera është edhe përfundimi i të drejtës për të përfituar shtesën e pagës për kushte pune për punonjësit në sektorët e IT, më datë 1 janar 2014. Gjithashtu, të mbahet në konsideratë në aplikimin e shtesave për kushte pune, ndryshimet strukturore të institucioneve. Në rast se vendimi aktual, ka të parashikuar një shtesë page për punonjësit në disa njësi organizative, të cilat me ristrukturimet e kryera nuk kanë më emërtesën e përcaktuar në këtë vendim, kjo shtesë nuk është më e vlefshme për aplikim.

V. Pagat e të gjithë punonjësve të administratës publike që klasifikohen si punonjës mbështetës, pavarësisht arsimimit individual të tyre, përcaktohen në vendimin nr. 551, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim.

VI. Pagat e punonjësve të sistemit arsimor, të sistemit shëndetësor, të sistemit me grada si dhe të punonjësve të Aviacionit Civil dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, përcaktohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.